



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

A. nr. 469 / 20

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, neni 4 Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, si dhe nenin 17 paragrafi 3 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/20 me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE “BRT shpk , të parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën e Busisë” me numër të prokurimit :AP 616-19-9179-5-2-1, të iniciuar nga AK Komuna e Prishtinës, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardia Behra me datën: 23.07.2020 mori këtë :

VENDIM

- I. **Hedhet si e pa lejuar** ankesa e OE “BRT shpk Prishtinë, me nr. të protokollit. 469/20, e datës: 14. 07. 2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën e Busisë” me numër të prokurimit :AP 616-19-9179-5-2-1, të iniciuar nga AK Komuna e Prishtinës, pasi që ankuesi nuk e ka bërë sigurimin e tarifës së ankesës .

- II. **LEJOHET** autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës , që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën e Busisë” me numër të prokurimit :AP 616-19-9179-5-2-1, te iniciuar nga AK Komuna e Prishtinës përkitazi me këtë ankesë, (nëse nuk ka ankesë tjetër).

ARSYETIM

Më datën: 14 07 2020, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën e parashtruar nga ana e OE “BRT shpk me nr. të protokollit 469/20, të parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën e Busisë” me numër të prokurimit :AP 616-19-9179-5-2-1,” me numër të prokurimit :AP 616-19-9179-5-2-1, te iniciuar nga AK Komuna e Prishtinës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesën e parashtruar nga OE “BRT shpk, me numër të protokollit 469/20, të datës: 14. 07. 2020, të parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën e Busisë” me numër të prokurimit :AP 616-19-9179-5-2-1, te iniciuar nga AK Komuna e Prishtinës, pas analizimit të ankesës në fjalë konstaton se ankesa duhet të hedhet si e pa lejuar nga fakti se OE ankues nuk e ka paguar tarifën e sigurimit të ankesës , ashtu siç parashihet me nenin 13.7 të Rregullores së punës së OSHP-së, me numër 01/20 dhe numër të protokollit nr. 83/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konstaton se në pajtim me nenin 109 të LPP-së, ankesa mund të hyje në shqyrtim vetëm pasi të jen plotësuar të gjitha kushtet të cilat parashihen në këtë nen, në rastin konkrete ankesa me numër të protokollit 469/20 e datës 14 .07.2020, nuk është e plotë nga se ankuesi nuk e ka bere sigurimin e ankese edhe për kundër faktit se zyra për pranim të

ankesave dhe protokollit e OSHP-së, kanë kontaktuar me ankuesin duke e informuar se duhet të bëjnë sigurimin te ankesës sipas tarifës së paraparë me LPP dhe me Rregulloren e Punës së OSHP-së, në mënyrë që ankesa e tyre të mund të procedohen për shqyrtim dhe vendimmarrje. OSHP sqaron se edhe përkundër këtyre përpjekjeve ankuesi nuk e ka bërë sigurimin e tarifës së ankesës për ankesën në fjale andaj konstatojmë se e njëjta ankesë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë fare në shqyrtim nga OSHP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron, se zyra për pranimin e ankesave dhe zyra e arkives i është drejtuar OE “BRT shpk”, përmes telefonit dhe me emal me datën 14.07.2020, duke i kërkuar që të bëjnë sigurimin e tarifës së ankesës së tij në mënyrë që ankesa e ti të procedohet më tutje, mirëpo i njëjti OE nuk është përgjigjur me ndonjë konfirmim apo dëshmi të pagesës së bërë .

Organi Shqyrtues i Prokurimit është në dijeni se OE në fjalë të njëjtin veprim për mos pagim të sigurimit të tarifës së ankesës po e përsërit për herën e dytë, ku një veprim të këtillë e ka bërë edhe për ankesën me nr. 432/20, andaj sqarojmë se veprime të këtilla në prolongim të proceseve lidhur me aktivitet e prokurimit nuk do të duhet te jen të praktikuara nga operatorët ekonomik seriozë të cilët marrin pjesë apo dëshirojnë të marrin pjesë në aktivitetet të ndryshme të prokurimit.

Duke pas parasysh faktin se OE ankues “BRT shpk , nuk ka deponuar sigurimin e ankesës në OSHP, kryesuesi i Sekretariatit sqaron, se për këtë fakt në diapozitiv të këtij vendimi nuk është vendosur fare lidhur me tarifën e sigurimit të ankesë

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Prishtinës

1x1 OE “BRT shpk ,

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së